

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin dhjetor

2024

janar 2025

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin dhjetor

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, janar 2025

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

01.

Publikimet në gjuhën shqipe

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

Temat e përdorura për krijimin dhe

shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën

shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

02.

Publikimet në gjuhën serbe

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

Temat e përdorura për krijimin dhe

shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën

shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

03.

Kontrulli dhe vlerësimi i deklaratave

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë dhjetorit 2024, bazuar në të dhënat e siguruar nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është i pari dhe i vetmi i llojit. Është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i 30-të mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma hibrid.info e specializuar në kontroll të fakteve, edukim digjital dhe medial, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në këtë raport monitorues jepet një pasqyrë për formën e përmbajtjeve me karakter informues për dhe rreth ngjarjeve në Kosovë. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të japë një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:

- Vlerësimet e artikujve keqinformues;
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese;
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues;
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues;
- Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave.


Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info, e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti, është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Klasifikimi i publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe (të tjera)

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE

Publikimet në gjuhën serbe
20%



Publikimet në gjuhën shqipe
77%

Mostra e monitorimit dhe trajtimit të përmbajtjeve keqinformuese nga platforma “hibrid.info” fokusohet në keqinformimet në gjuhën shqipe, të publikuara në media, portale të dyshimta, si dhe faqe dhe llogari në mediat sociale. Si rezultat, gjatë muajit nëntor 2024, publikimet në këtë gjuhë përbënin 77% të rasteve të trajtuara.

Gjatë muajit nëntor, në kuadër të monitorimit, janë trajtuar 66 përmbajtje, ku 52 (77%) prej tyre ishin në gjuhën shqipe ndërsa 13 (20%) në gjuhën serbe dhe angleze 1 (3%).

1

Publikimet në gjuhën shqipe

Gjatë analizës së përmbajtjeve keqinformuese për muajin dhjetor 2024, është evidentuar se 77% (51 nga gjithsej 66 përmbajtje keqinformuese të identifikuara) ishin në gjuhën shqipe.

Në dhjetor 2024, një analizë e 51 përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe zbuloi se kategoria kryesore ishte “Lajm i rremë”, që përbënte 38% të rasteve, duke reflektuar përhapjen e lajmeve të fabrikuara. “Mashttrim” ishte kategoria e dytë më e zakonshme, me 19%, që përfshinte manipulime të qëllimshme. Kombinimi i këtyre dy kategorive, “Lajm i rremë / Mashttrim”, zuri 10% të rasteve, ndërsa “Dezinformatë” përbënte 8%, duke treguar përhapjen e informacioneve të pasakta.

Në dhjetor 2024, temat kryesore kanë përfshirë zhvillime politike dhe çështje të tjera të rëndësishme. Zgjedhjet në Kosovë përbënin 21% të përmbajtjeve, duke u fokusuar në debatet dhe ndikimet e procesit zgjedhor. Gjykata Speciale zuri 8%, me diskutime mbi çështje juridike dhe pretendime të ndryshme. Gjatë muajit dhjetor, përmbajtjet keqinformuese u shpërndanë në fusha të ndryshme, me politikën që dominoi me 54%, duke përfshirë zgjedhjet dhe zhvillimet në veri, ndërsa fusha sociale zuri 17%, siguria 13%, drejtësia 8%, dhe infrastruktura dhe shëndetësia secila me nga 4%. Gjatë muajit dhjetor, 83% e përmbajtjeve keqinformuese u shpërndanë në media sociale, 15% në media reale, dhe vetëm 2% nga media të dyshimta.

Përqindja e përmbajtjeve në
gjuhën shqipe




Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

1.1

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese




Analiza e 51 përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe gjatë muajit dhjetor 2024 ka zbuluar një përqindje domethënëse të rasteve të keqinformimit në kategori të ndryshme.

Gjatë dhjetorit 2024, një analizë e 51 përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe zbuloi se kategoria që dominoi ishte “Lajm i rremë”, që përbënte 37% të rasteve, duke treguar përhapjen e lajmeve të fabrikuara që synojnë të mashtrojnë lexuesit. Kategoria e dytë më e zakonshme ishte “Mashtrim”, që përfaqësonte 20% të përmbajtjeve dhe përfshinte manipulime të qëllimshme për të shtrembëruar të vërtetën. Një kombinim i këtyre dy kategorive, i emërtuar si “Lajm i rremë / Mashtrim”, zuri 10% të rasteve duke reflektuar ndërthurjen e këtyre dy formave të keqinformimit. Po ashtu, “Dezinformatë” përbënte 8% të analizës, duke përfshirë përhapjen e informacionit të pasaktë ose të shtrembëruar që mund të jetë me qëllim ose pa qëllim.

Forma të tjera të keqinformimit përfshinin “Clickbait” (6%), e cila shfrytëzon tituj sensacionalë për të tërhequr lexuesit, dhe “Përmbajtje e paverifikuar” (4%), ku informacioni publik nuk ishte i mbështetur në burime të besueshme. Kategoritë më pak të zakonshme përfshinin “Deklaratë të pavërtetë” (2%), “Teori konspirative” (2%), dhe “Manipulim i fakteve” (2%), duke treguar përhapjen e narrativave të fabrikuara dhe të pabazuara. Gjithashtu, ishin të pranishme kombinime si “Dezinformatë / Përmbajtje e paverifikuar” (2%), “Deklaratë e paargumentuar / Përmbajtje e paverifikuar” (2%), dhe “Deklaratë gjysmë e vërtetë” (2%). Në fund, “Satira” zuri gjithashtu 2% të rasteve, duke krijuar sfida në dallimin e saj nga përmbajtjet e tjera keqinformuese.

Krahasuar me muajin nëntor 2024, dhjetori shfaq një ndryshim të dukshëm në shpërndarjen e kategorive të keqinformimit në gjuhën shqipe. Në dhjetor, “Lajmi i rremë” shënoi një rritje të konsiderueshme nga 27% në 37%, duke u bërë kategoria dominuese, ndërsa “Dezinformatë” ra nga 14% në 8%. Gjithashtu, “Mashtrimi” pësoi një rritje nga 10% në 20%, duke treguar një shtim të rasteve me qëllim manipulues. Ndërkohë, përmbajtjet “Clickbait” ranë nga 12% në 6%, duke treguar një reduktim të përmbajtjeve sensacionaliste. Kategoritë kombinuere si “Dezinformatë / Clickbait” (8%) dhe “Lajm i rremë / Mashtrim” (3%) u zvogëluan, ndërsa kombinimet e tjera si “Përmbajtje e paverifikuar / Dezinformatë” mbetën në 2-3%.



38% e artikujve keqinformues të trajtuar kanë marrë vlerësimin “lajm i rremë”.

1.1.1.

Analizë e llojeve të vlerësimeve

01. Lajm i rremë

Pothuajse të gjitha lajmet e rreme janë publikuar në media sociale nga fusha e politikës. Dy temat kryesore për të cilat u keqinformua kryesisht në media sociale janë keqinformatat ndërlidhur me zgjedhjet (përfshirë edhe sondazhet zgjedhore) me 13% dhe sulmi në kanalin e ujit Ibër-Lepenc me 4%. Pretendime të rreme për tema përfshirë atë se KQZ-ja nuk e ka certifikuar koalicionin “Lista për Familjen”, apo se ambasadori i ShBA-së, Jeff Hovenier ka kritikuar Ramush Haradinajn. Po ashtu, u shpërndanë lajme të pabazuara që Edi Rama mbështet Bedri Hamzën për kryeministër të Kosovës, dhe se analisti Dardan Gashi ka deklaruar që Kurti nuk është dorëzuar kurrë. Pretendime të pavërteta përfshijnë edhe atë se Agim Veliu ka thënë që LDK nuk ka mundësi përballë Kurtit, ndërsa gjenerali serb Milan Mojsilović nuk ka konfirmuar se ministri Ejup Maqedonci ka kërkuar mbështetjen e tij. Raportimi se Besarta Jashari do të jetë kandidate për deputete nga VV-ja doli gjithashtu i pasaktë.

02. Mashtrim

Përmbajtjet mashtruese janë publikuar kryesisht në media sociale nga fusha e sociale. Përmbajtjet mashtruese dhe SMS mashtrues shpesh përfshijnë tema si produktet shëruese, të cilat premtojnë efekte të pabazuara shkencërisht. Po ashtu, shpërndahen sondazhe të rrejshme zgjedhore për të krijuar një imazh të shtrembëruar të situatës politike, si dhe oferta mashtruese për dhënie kredish dhe mundësi banimi, që shpesh çojnë në mashtrime financiare. Vazhdojnë SMS-të mashtrues në WhatsApp, që paralajmërojnë mbylljen e llogarisë në Facebook dhe imitojnë ueb-faqen e Postës së Kosovës, duke manipuluar përdoruesit.

03. Lajm i rremë / Mashtrim

Të gjitha keqinformatat të cilat janë vlerësuar si “Lajm i rremë/Mashtrim” janë publikuar në media sociale nga fusha e drejtësisë dhe politikës. Temat kryesore ishin: Gjykata Speciale, Sondazhe zgjedhore, Zgjedhjet në Kosovë, dhe Shtesat 100 euro, duke u fokusuar në çështje juridike, zgjedhore dhe financiare. Temat lidhur me Gjykatën Speciale përfshijnë pretendime të rrejshme dhe mashtruese, siç është pohimi i liritimit të Thaçit dhe Veselit përmes një postimi të manipuluar kinse të Haradinajt në Facebook. Po ashtu, është publikuar një fotografi e manipuluar e Donald Trumpit, me mbishkrimin se ai ka deklaruar mbështetje për shtetin e Kosovës dhe lirimin e udhëheqësve të UÇK-së nga Haga. Lidhur me zgjedhjet, u publikua një sondazh i rremë dhe një imazh i manipuluar për moscertifikimin e Listës Serbe nga KQZ-ja.

04. Dezinformatë

Dezinformatat janë publikuar në media sociale duke dominuar ato nga fusha e sigurisë. Temat për të cilat u dezinformua përfshijnë: Veriun, Kufirin Kosovë-Serbi, Armatosjen e Policisë dhe Gjykatën Speciale. Lidhur me veriun, u pretendua se pamjet nga Mitrovica e Jugut ishin rrejshëm të paraqitura si pamje festive nga komunitat veriore me shumicë serbe. Për Kufirin Kosovë-Serbi, një imazh i vjetër u përdor për të pretenduar se xhandarmëria serbe po hynte në Kosovë. Në lidhje me Armatosjen e Policisë, u publikua një lajm i vjetër për dhurimin e shtatë dronëve nga ShBA-ja për Policinë e Kosovës. Për Gjykatën Speciale, u shpërnda një deklaratë e manipuluar se Vlora Çitaku kishte thënë se ishin mashtruar pasi kishin shpresuar që Hashim Thaçi nuk do të akuzohej.


Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë: + Clickbait, Përmbajtje e paverifikuar, Deklaratë e pavërtetë, Teori konspirative, Manipulim i fakteve, Dezinformatë/Përmbajtje e paverifikuar, Deklaratë e paargumentuar/Përmbajtje e paverifikuar, Deklaratë gjysëm e vërtetë, Përmbajtje e paverifikuar/Dezinformatë, Satirë.

1.2

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave



Gjatë muajit dhjetor 2024, temat që kanë dominuar janë të ndryshme dhe lidhen me zhvillime politike dhe çështje të tjera të rëndësishme. Zgjedhjet në Kosovë kanë qenë tema kryesore, duke përfaqësuar 22% të përmbajtjeve, e cila ka përfshirë debate dhe informacione të ndryshme mbi procesin zgjedhor dhe ndikimin e tij. Gjykata Speciale ka qenë gjithashtu një temë e rëndësishme, duke zënë 8% të përmbajtjeve, ku janë diskutuar çështje juridike dhe pretendime të ndryshme lidhur me të. Po ashtu, SMS mashtrues kanë përfaqësuar 8% të përmbajtjeve, duke theksuar përdorimin e mesazheve mashtruese për të manipuluar qytetarët.

Temat e tjera përfshijnë Veriun (6%), ku janë shpërndarë informacione dhe dezinformata lidhur me situatën në këtë rajon, dhe Sondazhe zgjedhore (6%), ku janë publikuar sondazhe të rrejshme dhe manipuluese. Shtesat 100 euro kanë përfaqësuar 4% të përmbajtjeve, ku është diskutuar ndikimi i këtyre shtesave financiare në qytetarët dhe ekonominë e Kosovës.

Nëse bashkojmë temat Zgjedhjet në Kosovë (22%) dhe Sondazhet zgjedhore (6%), ato përbëjnë një total prej 28%, duke treguar se këto tema kanë pasur një dominim të rëndësishëm gjatë muajit dhjetor.

Kur krahasojmë temat e muajve nëntor dhe dhjetor 2024, Zgjedhjet në Kosovë janë të pranishme në të dy muajt, por me një rritje të ndjeshme në dhjetor, ku ato zënë 22%, krahasuar me 10% në nëntor. Ky ndryshim tregon një fokus të shtuar në zhvillimet zgjedhore dhe politikën në përgjithësi në Kosovë gjatë dhjetorit. Gjykata Speciale është një tjetër temë, por ka mbetur në një nivel të ngjashëm, duke zënë 8% në të dy muajt, duke treguar se kjo çështje ka mbetur e rëndësishme gjatë të dy periudhave.

Sa i përket temave të sigurisë, nëntori kishte një fokus të theksuar në Armatosjen e FSK-së (10%), që ishte një nga temat kryesore, ndërsa dhjetori përqendrohej më shumë në përhapjen e SMS-ve mashtrues (8%), duke treguar një zhvendosje nga çështjet e sigurisë ushtarake në keqinformime dhe manipulime online. Ndërsa Sondazhet Zgjedhore ishin të pranishme në të dy muajt (5% nëntor dhe 6% dhjetor), ato ishin më të theksuara gjatë dhjetorit, duke pasqyruar një rritje të interesit për proceset zgjedhore dhe manipulimet e mundshme me sondazhet.



44% e temave kryesore janë për zgjedhjet (sondazhe) zgjedhore, SMS mashtrues dhe Gjykata Speciale.

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

1.2.1.

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hibrid.info, përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Zgjedhje në Kosovë

Përmbajtjet keqinformuese lidhur me zgjedhjet në Kosovë u shpërndanë kryesisht në media sociale (18%), ndërsa në media tradicionale përbënin 4%. Këto përmbajtje kryesisht janë vlerësuar si Lajm i rremë. Në media është publikuar një lajm i rremë që raportonte pasaktësisht se Besarta Jashari do të ishte kandidatë për deputete nga radhët e LVV-së. Po ashtu, është shpërndarë një artikull me titull clickbait “Kurti lihet jashtë listës: Kam vendosur të mos rikandidoj”, duke krijuar konfuzion tek lexuesit dhe duke i orientuar ata të mendojnë se bëhej fjalë për Albin Kurtin, ndërkohë që në fakt bëhej fjalë për Tinka Kurtin nga LVV. Në media sociale janë publikuar pretendime të rreme, përfshirë: Opozita në Kosovë që ka paralajmëruar se do ta dërgojë në Kushtetuese moscertifikimin e Listës Serbe nga KQZ; KQZ-ja nuk e ka certifikuar koalicionin “Lista për Familjen”; pretendime të pasakta se Edi Rama mbështet Bedri Hamzën për kryeministër; dhe Hovenier ka kritikuar Haradinajn; si dhe Agim Veliu të ketë thënë se LDK nuk ka mundësi përballë Kurtit.

02. Gjykata speciale

Lidhur me Gjykatën Speciale, keqinformatat janë shpërndarë kryesisht në media sociale (6%), ndërsa përmes mediave tradicionale janë përhapur më pak, përkatësisht 2%. Këto keqinformata janë vlerësuar kryesisht si Lajm i rremë / Mashtrim, Dezinformatë dhe Përmbajtje e paverifikuar. Në media është publikuar një përmbajtje e paverifikuar për arrestimin e Hajredin Kuçit, ndërsa në media sociale janë shpërndarë pretendime të rreme, përfshirë një deklaratë të Vlora Çitakut për Hashim Thaçin, një imazh të gjeneruar nga inteligjenca artificiale, dhe një postim të manipuluar kinse të Ramush Haradinajt për lirin e Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit.

03. SMS mashtrues

Të gjitha keqinformimet mbi këtë temë janë shpërndarë përmes platformës sociale WhatsApp, duke u përqendruar kryesisht në çështje të natyrës sociale, e të cilat u vlerësuan si mashtrime. Në WhatsApp janë shpërndarë mesazhe mashtruese që përfshijnë pretendime të rreme, si njoftime për mbylljen e llogarive në Facebook, vegëza që imitojnë ueb-faqen e Postës së Kosovës dhe SMS që pretendojnë të vijnë nga Facebook.

03. Veriu


Keqinformatat lidhur me veriun janë publikuar kryesisht në media sociale (4%) dhe më pak në media reale (2%), duke pasur origjinë kryesisht nga fusha e sigurisë. Në media tradicionale është publikuar pretendimi dezinformues se Drizan Shala ka deklaruar: “Në kufi me Kosovën ka 22 baza ushtarake serbe, qytetarët marrin armë”. Ndërkohë, në media sociale janë shpërndarë pretendime të rreme, si paraqitja e marshimit të kadetëve të FSK-së në rrethinën e Batllavës si patrullë pas shpërthimit në Zubin Potok, si dhe përdorimi i pamjeve nga Mitrovica e Jugut për t'i paraqitur ato si festive në komunat veriore me shumicë serbe.

1.3

Llojet e fushave

Si rezultat i gjetjeve lidhur me përmbajtjet keqinformuese të trajtuara gjatë muajit nëntor, rezulton se publikues të ndryshëm (media reale dhe mediat sociale) kanë prodhuar dhe shpërndarë kryesisht përmbajtje keqinformuese në fushën e politikës, e cila përbën 55% të totalit.

FUSHAT KRYESORE
Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Gjatë muajit dhjetor, përmbajtjet keqinformuese ishin të shpërndara në disa fusha kryesore. Politika dominoi me 55% të totalit, duke përfshirë tema si zgjedhjet dhe zhvillimet në veri. Fusha sociale zuri 18%, me keqinformime të fokusuar te çështje të përditshme dhe mashtrime përmes mesazheve. Siguria përbënte 13%, me pretendime të rreme për situata në kufi dhe armatosje. Drejtësia zinte 8%, kryesisht me përmbajtje të lidhura me Gjykatën Speciale. Ndërkohë, fushat e infrastrukturës dhe shëndetësisë kontribuan secila me 4%.

Gjatë muajit dhjetor, përmbajtjet keqinformuese u dominuan nga fusha e politikës (55%), që shënon një rritje të konsiderueshme krahasuar me nëntorin, kur politika zinte vetëm 37%. Po ashtu, fusha e sigurisë ra ndjeshëm nga 25% në nëntor në 13% gjatë dhjetorit. Përmbajtjet nga fusha sociale u rritën nga 10% në nëntor në 18% gjatë dhjetorit, ndërsa ato nga drejtësia mbetën të qëndrueshme me një ndryshim të vogël (8% në të dy muajt). Në dhjetor nuk u raportuan keqinformime të dukshme në kategori si sporti, arsimit, turizmi apo katastrofat natyrore, të cilat kishin përfaqësim të vogël në nëntor. Kjo tregon një fokus më të madh te temat politike dhe sociale gjatë dhjetorit.



93% e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara janë nga fusha e politikës, sociale, siguri dhe drejtësi.

Llojet e publikuesve


1.4

Duke u bazuar në analizat e përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe, rezulton se keqinformatat nga faqet dhe llogaritë në mediat sociale vazhdojnë të jenë të pranishme në mënyrë të theksuar edhe gjatë muajit nëntor.

Gjatë muajit dhjetor, përmbajtjet keqinformuese u shpërndanë kryesisht në media sociale (82%), ndërsa vetëm një pjesë e vogël e këtyre përmbajtjeve u publikua në media reale (15%). Pjesa më e vogël e keqinformatave (2%) u përhap nga media të dyshimta.

Në krahasim me muajin nëntor, gjatë muajit dhjetor ka pasur një rritje të përqindjes së përmbajtjeve keqinformuese të shpërndara në media sociale, nga 81% në 82%. Pjesa e mediave reale ka mbetur e në një diferencë me 15% në të dy muajt, ndërsa portale të dyshimta kanë shënuar të njëjtën përqindje, 2%, si nëntori.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE



82% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga publikuesit në media sociale

Llojet e mediave sociale


1.5

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në media sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Gjatë muajit dhjetor, përmbajtjet keqinformuese janë shpërndarë kryesisht në TikTok (55%), duke dominuar platformën më shumë se Facebook (36%) dhe WhatsApp (9%). Ky trend tregon se TikTok ka vazhduar të jetë një burim i rëndësishëm i shpërndarjes së informacioneve të pasakta në këtë periudhë.

Në krahasim me muajin nëntor, gjatë dhjetorit është vërejtur një rënie e lehtë e përqindjes së përmbajtjeve keqinformuese në TikTok, nga 57% në 55%, ndërsa Facebook ka mbajtur një përqindje të qëndrueshme prej 36%. WhatsApp ka shënuar një rritje të vogël, duke arritur në 9%.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË
MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

1.6

Kjo matje, përmes të dhënave monitoruese, analizon ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Në mediat sociale, përmbajtjet keqinformuese janë shpërndarë nga lloje të ndryshme publikuesish.

Gjatë muajit dhjetor, përmbajtjet keqinformuese në Facebook janë shpërndarë nga lloje të ndryshme publikuesish. Faqet kanë dominuar me 26%, pasuar nga faqet zyrtare me 7% dhe llogaritë personale me 2%. Në TikTok, këto përmbajtje janë shpërndarë kryesisht nga llogaritë personale, që përbëjnë 51% të totalit, ndërsa faqet kanë kontribuar me 2%. Në WhatsApp, përmbajtjet keqinformuese janë shpërndarë kryesisht përmes numrave të telefonit, që përbëjnë 9% të totalit.



1.6.1.

Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

01. TikTok

Në TikTok, përmbajtjet keqinformuese janë fokusuar kryesisht në temat politike, duke përbërë 38% të totalit të përmbajtjeve të pasakta. Gjatë muajit dhjetor, në TikTok, përmbajtjet keqinformuese kanë përfshirë kryesisht katër tema: zgjedhjet në Kosovë (14%), sondazhe zgjedhore (7%), shtesat 100 euro (5%) dhe Gjykata Speciale (5%).

02. Facebook


Gjatë muajit dhjetor, në Facebook, përmbajtjet keqinformuese kanë dominuar kryesisht në fushat e politikës (14%) dhe sigurisë (7%). Në Facebook, temat që kanë përfshirë keqinformata janë përqendruar te zgjedhjet në Kosovë (7%), sulmi në kanalin Ibër-Lepenc (5%) dhe veriu (5%).

Figurat dhe institucionet më të përfolura

1.7.

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.

RENDITJA E INSTITUCIONEVE
MË TË PËRFOLURA SIPAS
PËRQINDJES



Sipas analizës së 51 përmbajtjeve keqinformuese të identifikuara dhe trajtuara gjatë muajit tetor 2024, ka rezultuar se 6 prej këtyre përmbajtjeve përmendin institucione të ndryshme.


Partitë Politike (LVV, LDK, PDK, AAK) janë institucionet më të përfolura gjatë muajit dhjetor në gjuhën shqipe. Këto subjekte politike u përfolën në dy sondazhe të rreme zgjedhore të publikuara në media sociale, duke përfshirë pretendime të pavërteta dhe të manipuluar.

LDK u përfol në një pretendim të rremë se Ekrem Hyseni ishte shprehur pro shkëmbimit të territoreve si zgjidhje e vetme për problemin e veriut të Kosovës.

LDK dhe PDK u përfolën në një deklaratë të pavërtetë se Richard Grenelli kishte thënë që PDK-ja dhe LDK-ja kishin shprehur gatishmëri për ndarjen e Kosovës.

Lista për Familjen u përfol në një pretendim të rremë që thoshte se KQZ-ja nuk e kishte certifikuar këtë koalicion për pjesëmarrje në zgjedhje.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Në muajin dhjetor, kryeministri i Kosovës dhe kryetari i LVV-së, Albin Kurti, ishte figura më e përmendur në përmbajtjet keqinformuese në gjuhën shqipe, duke u përmendur në 10 raste të tilla, përfshirë edhe në krahasim me figura të tjera politike.

Albin Kurti u përmend në një seri pretendimesh të pavërteta gjatë muajve të fundit. Kjo përfshin pretendimin për hyrjen e xhandarmërisë serbe brenda territorit të Kosovës, i cili u verifikua si i pavërtetë, dhe një postim në TikTok që pretendonte se Kurti kishte marrë një vendim për të shpërndarë 100 euro për secilin qytetar të Kosovës për festat e fundvitit. Po ashtu, një imazh pretendon se Lidhja Demokratike e Kosovës ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese vendimin për ndarjen e 100 euro për fëmijët dhe pensionistët, ndërsa një tjetër imazh pretendon se Kurti kishte deklaruar se duhet harruar e kaluara me serbët dhe ka ardhur koha për paqe me shtetin serb. Artikuj të tjerë pretenduan se raportimi i mediave në gjuhën shqipe në Kosovë për protestat në Serbi ishte një dëshmi e mbështetjes së Kurtit për shkatërrimin e Serbisë, dhe një imazh i përkthyer nga një gazetar gjerman pretendonte se ai ishte quajtur spiun serb dhe se komunizmi po kthehej në Kosovë. Të tjera pretendime lidhen me një vizitë të Kurtit në Bosnjë-Hercegovinë, ku thuhet se ai nuk kishte pranuar të ketë flamur të Kosovës, dhe një tjetër për një deklaratë të tij në Sarajevë ku thuhej se nuk pyeste kreun e entitetit të Republikës Serbe, Millorad Dodik, për me kë mund të takohet.

Figura e dytë më e përfolur ishte ministri i Punëve të Jashtme të Turqisë, Hakan Fidan, i cili u përmend në dy përmbajtje keqinformuese.

Ka pasur pretendime të rreme që ministri turk Fidan, ka paralajmëruar njohjen e Kosovës nga Siria, një informacion i pavërtetë që ka qarkulluar në disa media. Gjithashtu, ka pasur një tjetër dezinformim që ka pretenduar se agjencia turke e inteligjencës është angazhuar për parandalimin e mundësisë së një sulmi terrorist në Kosovë, i cili gjithashtu është i pavërtetë dhe nuk ka bazë faktike.

Të gjitha personalitetet tjera janë përfolur nga një herë në keqinformatat e publikuara gjatë muajit dhjetor.

2.

Publikimet në gjuhën serbe

Nga analiza e 66 përmbajtjeve keqinformuese, 13 prej tyre (20%) rezultuan të publikuara në gjuhën serbe. Të gjitha këto përmbajtje janë shpërndarë në media, duke përfshirë informacione të pasakta dhe të paqëndrueshme. Përmbajtjet keqinformuese kryesisht lidhen me fushat e politikës dhe sigurisë, me përparësi në përmbajtjet politike. Sa i përket kategorive të keqinformimit, teoritë konspirative dominojnë në këtë grup.

Temat kryesore: Temat kryesore për të cilat është keqinformuar në gjuhën serbe, përfshijnë disa çështje të rëndësishme. Sulmi në kanal in Ibër-Lepenc dhe protesta në Serbi udhëhoqën me nga 23% të keqinformacioneve. Ndërkohë, çështje të tjera si e ashtuquajtura “shtëpia e verdhë”, terrorizmi ndërkombëtar, flamuri i Kosovës si provokim, vendbanimet me shumicë serbe, origjina e Anna Oxas, dëmtimi i varrezave serbe dhe Shqipëria e madhe, secila përbënin 8% të përmbajtjeve të pasakta.

Sa i përket temës së sulmit në kanal in Ibër-Lepenc, janë përfshirë disa konspiracione dhe pretendime të pabaza. Kështu, është spekuluar se shpërthimi në Zubin Potok ka qenë një “mashtim nën skenarin” e Kryeministrit Albin Kurti. Kryeministri i Serbisë, pa ofruar fakte, e ka quajtur shpërthimin një “regji të Kurtit” dhe ka lidhur ngjarjen me ndalimin e deputetëve të Listës Serbe. Gjithashtu, janë bërë deklarata të pabaza që pretendojnë se shpërthimi në Zubin Potok është inskenuar, duke përfshirë dezinformata dhe duke krijuar një perceptim të rremë mbi ngjarjen.

Në lidhje me protestat opozitare në Serbi, janë përfshirë disa keqinformata që lidhen me Albin Kurtin. Media dhe zyrtarë serbë kanë shpërndarë dezinformata duke pretenduar, pa asnjë fakt, se Kurti po organizon një protestë në Cyril kundër Presidentit Vuçiq. Po ashtu, një fotografi e një protestuesi në Novi Sad është paraqitur pa asnjë bazë si dëshmi se po promovohet ideja e “Shqipërisë së madhe”. Këto shpërndarje të pasakta kanë kontribuar në krijimin e një perceptimi të rremë dhe të pasigurt mbi ngjarjet dhe politikat e përfshira.

Kategoritë e vlerësimit: Kategoritë e vlerësimit të përmbajtjeve keqinformuese tregojnë një dominim të teorive konspirative, të cilat përbëjnë 38% të totalit. Ndërkohë, 23% e përmbajtjeve janë teori konspirative të shoqëruara me deklarata të paargumentuara. Narrativat serbe përbëjnë 15% të përhapjeve të pasakta, ndërsa dezinformatat dhe manipulimi i fakteve kanë kontribuar gjithashtu me 15% dhe 8%, përkatësisht. Këto kategori pasqyrojnë mënyrat kryesore se si janë shpërndarë informacionet e rreme dhe të paqëndrueshme, duke ndikuar në formimin e perceptimeve të pasakta.

Sa i përket fushave, përmbajtjet keqinformuese janë përqendruar kryesisht në politikë (38%) dhe siguri (31%). Pjesa tjetër e përmbajtjeve përfshin tema sociale (15%), kulturore (8%) dhe sportive (8%). Këto përqendrime tregojnë se politikat dhe çështjet e sigurisë kanë qenë objekt i shpërndarjes së informacionit të pasaktë, ndërsa fushat e tjera kanë pasur një ndikim më të vogël në përhapjen e dezinformatave.

Personat që janë përfolur në keqinformata në gjuhën serbe përfshijnë kryesisht kryeministrin Albin Kurti, i cili përbën 44% të përmbajtjeve të pasakta. Ndërkohë, emrat e tjerë që janë shpesh të përmendur përfshijnë zëvendëskryeministrin e Serbisë, Aleksandar Vullin, këngëtare shqiptaro-italiane Anna Oxa, protestuesin serb Milosh Rakiq dhe Albin Kurtin, shefin e Zyrës Serbe për Kosovën Petar Petkoviçin dhe Slavisha Vuksanoviçin, anëtar i Bordit Ekzekutiv të Shoqatës së Familjeve të Personave të Rrëmbyer dhe të Zhdukur nga Kosova – secili prej tyre duke përbërë 11% të përhapjeve të dezinformatave.

Konspirohet se shpërthimi në Zubin Potok ka qenë “mashtim nën skenarin” e Kurtit	Teori konspirative	Sulmi në kanalin Ibër-Lepenc	Siguri	Media
Mediat në serbisht pretendojnë pa fakte se Kurti po organizon protestë në Cyrih kundër Vuçiqit	Teori konspirative	Protesta në Serbi	Politika	Media
Deklarata të pabaza se shpërthimi në Zubin Potok është inskenuar	Teori konspirative/ Deklaratë e paargumentuar	Sulmi në kanalin Ibër-Lepenc	Siguri	Media
Kryeministri i Serbisë pa fakte e quan regji të Kurtit shpërthimin në “Ibër-Lepenc” dhe ndalimin e deputetëve të Listës Serbe	Teori konspirative/ Deklaratë e paargumentuar	Sulmi në kanalin Ibër-Lepenc	Siguri	Media
Fotografia e një protestuesi në Novi Sad paraqitet pa fakte si dëshmi se po promovohet “Shqipëria e madhe”	Teori konspirative	Protesta në Serbi	Politika	Media
Media serbe dezinformon se Ana Oxa ndërroi emrin për shkak të turpit nga origjina e saj shqiptare	Dezinformatë	Origjina e Ana Oxas	Kulturë	Media
Media në serbisht paraqet rrejshëm flamurin e fansave kosovare të Milanit si flamur të Kosovës	Manipulum i fakteve	Falmuri i Kosovës si provokim	Sport	Media
Ndërlidhje dezinformuese të protestave në Serbi me Albin Kurtin nga media dhe zyrtarë serbë	Narrativa dezinformuese	Protesta në Serbi	Politika	Media
Petar Petkoviç pretendon pa bazë se varrezat serbe në Gjilan janë dëmtuar nga shqiptarët	Teori konspirative/ Deklaratë e paargumentuar	Vendbanimet me shumicë serbe	Sociale	Media
Karikatura me narrativ konspiracionist për dëmtimin e varrezave serbe	Narrativat dezinformuese	Dëmtimi i varrezave serbe	Sociale	Media
Pretendime dezinformuese për përfshirjen e ish-pjesëtarëve të UÇK-së në terrorizmin ndërkombëtar	Dezinformatë	Terrorizmi ndërkombëtar	Siguri	Media
Zyrtarët serbë risjellin pretendimin konspirativ për “Shqipërinë e madhe”	Teori konspirative	Shqipëria e madhe	Politika	Media
Pretendohet rrejshëm se është vërtetuar që në “Shtëpinë e verdhë” janë kryer transplantime organesh	Teori konspirative	Shtëpia e verdhë	Politika	Media

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në baza të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjithë artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben si një ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore, dhe atë në formë kryesisht kuantitative, për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese një mujore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 31 dhjetor 2024, në të cilën janë trajtuar 66 përmbajtje keqinformuese.

Përfundime

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes një mujore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit dhjetor 2024, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Gjatë analizës së përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe për muajin dhjetor 2024, u identifikuan 66 raste, prej të cilave 77% (51 përmbajtje) përfshinin lajme të rreme dhe manipulime. Kategoria dominuesë ishte “Lajm i rremë”, që përbënte 37% të rasteve, pasuar nga “Mashttrim”, me 20%, dhe kombinimi i këtyre dy kategorive, “Lajm i rremë / Mashttrim”, që zuri 10% të përmbajtjeve. Përhapja e dezinformative gjithashtu ishte e dukshme, duke përbërë 8% të analizës.

Temat kryesore përfshinin zhvillime politike, me zgjedhjet në Kosovë që zinin 22%, dhe çështje të tjera si Gjykata Speciale (8%). Politika dominoi me 55% të përmbajtjeve, pasuar nga fusha sociale (18%), siguria (13%), drejtësia (8%), dhe infrastruktura e shëndetësia (nga 4% secila). Po ashtu, 82% e përmbajtjeve keqinformuese u shpërndanë në media sociale, 16% në media reale dhe 2% nga media të dyshimta. Në dhjetor 2024, përmbajtjet keqinformuese u shpërndanë kryesisht në TikTok (55%), duke e bërë këtë platformë burimin kryesor të informacionit të pasaktë, më shumë se Facebook (36%) dhe WhatsApp (9%).

Në analizën e 51 përmbajtjeve keqinformuese të tetorit 2024, 6 prej tyre përmendin institucione, ndërsa partitë politike (LVV, LDK, PDK, AAK) ishin më të përfolurat, për shkak të dy sondazheve të rreme zgjedhore të publikuara në media sociale, që përfshinin pretendime të pasakta. Gjithashtu, në 36 raste, janë përfolur personalitete publike e politike, me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, që ishte figura më e përmendur, duke u shfaqur në 10 raste të tilla.

Në analizën e 66 përmbajtjeve keqinformuese, 13 prej tyre (20%) ishin të publikuara në gjuhën serbe, duke përfshirë informacione të pasakta dhe të paqëndrueshme që kryesisht lidhen me politikën dhe sigurinë, me një dominim të teorive konspirative. Temat kryesore përfshinin sulmin në kanalën Ibër-Lepenc dhe protestat në Serbi, të cilat zinin nga 23% të keqinformacioneve, ndërsa çështje të tjera si Shtëpia e verdhë, terrorizmi ndërkombëtar, dhe Shqipëria e madhe përbënin 8% secila. Po ashtu, janë shpërndarë dezinformata për sulmin në Zubin Potok, ku pretendimet e paqëndrueshme lidheshin me Kryeministrin Albin Kurti.

Në lidhje me protestat opozitare në Serbi, është përhapur keqinformata se Albin Kurti po organizon protesta në Cyrih kundër Vuçiqit, si dhe një foto e protestuesit në Novi Sad është paraqitur si dëshmi e "Shqipërisë së madhe". Kategoritë kryesore të vlerësimit përfshijnë teorinë konspirative (38%), teorinë konspirative me deklaratatë të paargumentuara (23%), dhe dezinformatat (15%), duke pasqyruar shpërndarjen e informacioneve të pasakta. Politika dhe siguria janë fushat kryesore, përbëjnë 38% dhe 31% të përmbajtjeve keqinformuese, ndërsa Albin Kurti ishte figura më e përfolur, duke zënë 44% të përmbajtjeve të pasakta.

HIBRIDO.INFO